

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Atentat në Selanik/ Qëlluan me armë zjarri ndaj 32-vjeçarit por nuk e plagosën. Policia greke arreston 3 shqiptarë
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/-ne-selanik-qelluan-me-arme-zjarri-ndaj-32-vjecarit-por-nuk-e--i105884
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 17:08:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 17:08:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d154bc3579c0f7f0ee698c57609efd5c55075a460e86ecd8cf1500f829e7ed0b
TEKSTI	c79e27c39547b812fad6f85712cd9aa1a9a0259f93a48b0d6d453a95b37da0e0
PAMJA	b111d7dd534d0f85ae91348d2cddeddb68ce8f1bad7bb7b6b55fccd44182b5a9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4897dffa2a71aa1c9e3723b2da1ecbcb527a6d261a3a5f4546f7a9253537f782
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	e5d36276bdac6f0efd80a0011f78966ff078cd5aec9cbe323cc4b585e15f691e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/4897dffa2a71aa1c9e3723b2da1ecbcb527a6d261a3a5f4546f7a9253537f782

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)




Flash: re per naften/ Efekti ■ e gazetares Vjolanda Peca nga ■ e cila Sarandë ■ Boçi është shprehur ■ dekadë ardhs

AKTUALITET

Atentat në Selanik/ Qëlluan me armë zjarri ndaj 32-vjeçarit por nuk e plagosën. Policia greke arreston 3 shqiptarë

Piranjat Përditësimi i fundit 24 Shtator 2026, 19:08



Policia greke ka zbardhur një atentat të mbetur në tentativë, i ndodhur në janar të vitit 2025 në Selanik, ku shënjestër ishte 32-vjeçari shqiptar Danjel Dushku. Për ngjarjen janë arrestuar tre shtetas shqiptarë, të dyshuar si autorë të sulmit: Robert Elezaj, 33 vjeç, Sergio Elezaj, 31 vjeç dhe Rueldi Dragjoshi, 26 vjeç. Arrestimet u kryen në orët e mëngjesit të së mërkurës, gjatë një operacioni të koordinuar të policisë greke, në zbatim të urdhër-arresteve të lëshuara ndaj tyre.

Sipas hetimeve, ngjarja ka ndodhur mërkurën e 8 janarit dhe në orët e para të 9 janarit 2025, në një zonë të Selanikut. Tre të dyshuarit dyshohet se iu afruan 32-vjeçarit dhe hapën zjarr në drejtim të tij.

Sipas policisë greke, Robert Elezaj ka qëlluar me pistoletë ndaj Dushkut, por nuk ka arritur ta godasë. Nga të shtënat mbeti i plagosur një person tjetër që ndodhej pranë tij, ndërsa u dëmtua edhe një dyqan në zonë. Edhe Rueldi Dragjoshi dyshohet se ka qëlluar me armë në drejtim të Dushkut, pa e goditur atë. Ndërkohë, Sergio Elezaj dyshohet se i ka drejtuar armën 32-vjeçarit dhe se ka ndihmuar në organizimin dhe realizimin e sulmit. Hetuesit thonë se Sergio Elezaj kishte marrë me qira automjetin me të cilin tre të dyshuarit shkuan në vendngjarje. Ai qëndroi me ta gjatë përplasjes dhe më pas u largua së bashku me dy të dyshuarit e tjerë.

Nga ana tjetër, sipas autoriteteve greke, edhe Danjel Dushku ka përdorur armë zjarri gjatë përplasjes. Ai dyshohet se ka qëlluar në drejtim të tre personave, pa i plagosur. Plumbat kanë dëmtuar automjetin me të cilin ata kishin mbërritur në vendngjarje, si dhe një tjetër automjet të parkuar.

Tentoi të arratisesh nga policia

Gjatë operacionit për arrestimin e tre shqiptarëve, Sergio Elezaj ka tentuar t'u largohej efektivëve. Sipas policisë, ai doli në ballkonin e banesës, kaloi në çatinë e një shtëpie ngjitur dhe qëndroi aty deri sa u lokalizua dhe u arrestua. Gjatë kontrollit në banesë, policia gjeti dhe sekuestroi një pistoletë me karikator, shtatë fishekë dhe dy karta identiteti të falsifikuara. Autoritetet greke konstatuan gjithashtu se 31-vjeçari nuk dispononte dokumentacionin e kërkuar ligjor dhe rezultonte person në kërkim, pasi ndaj tij kishte një dënim të pazbatuar për armëmbajtje pa leje.

Edhe Robert Elezaj rezultonte person në kërkim. Sipas policisë greke, ndaj 33-vjeçarit kishte një dënim në pritje për lehtësimin e transportit të shtetasve të vendeve të treta që nuk plotësonin kushtet për të hyrë në Greqi. Edhe ai nuk dispononte dokumentet e kërkuara ligjore. Ndërkohë, 26-vjeçari Rueldi Dragjoshi rezultoi i dënuar më parë në Francë. Sipas autoriteteve greke, në vitin 2021 ai ishte dënuar me 15 muaj burgim për trafikim heroine dhe kokaine.

Të tre të arrestuarit tashmë do të përballen me procedurat gjyqësore në Greqi, ndërsa hetimet vijnë për zbardhjen e plotë të rrethanave dhe motiveve të atentatit.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 24 Shtator 18:45

[Açuge të eksportuara nga Shqipëria hiqen nga tregu në Itali! Shkak prania shumë e lartë e histaminës](#)

Një sasi açugesh të eksportuara nga Shqipëria në Itali dhe që tregtoheshin për konsumatorët e shtetit fqonj kanë...

AKTUALITET 24 Shtator18:39

"Shqipëria kërkon revolucion"/ Sot dita e 117-të e protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë

Qytetarët do të mbledhen sot në protestën e 117-të radhazi kundër qeverisë Rama. Për më shumë se tre muaj, qyt...

AKTUALITET 24 Shtator18:36

Në kulmin e krizës, qeveria vendos tarifë të re për naftën/ Efekti deri në 42 mln euro/vit

Në kulmin e krizës së çmimeve, karburanteve pritet t'u shtohen edhe 40 mln euro të tjera në vit barra fiskale nga vendosja...

AKTUALITET 24 Shtator18:36

Nuk u kthye në shtëpi, punëtori shqiptar gjendet i vdekur në vendin e punës

Kur familjarët panë se ai nuk po kthehej, njoftuan policinë. Dhe pikërisht në kantierin ku ai punonte, në rrugën Goito, n&eum...

AKTUALITET 24 Shtator18:19

Gara për KLGJ-në, nesër vendoset për tre anëtarët e rinj! Ja kush janë kandidatët

Tre anëtarë të rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor pritet të zgjidhen ditën e nesërme, më 25 shtator...

AKTUALITET 24 Shtator18:10

EMRAT/ 63-vjeçari i intubuar te Trauma. Çfarë ndodhi në Sarandë një javë më parë që u mbajt e fshehtë nga policia

Një ngjarje e rëndë e ndodhur më 16 shtator në Sarandë, e cila nuk ishte bërë publike më herët, ka përfun...

AKTUALITET 24 Shtator17:49

Ish-shefja e SHISH në hetim, Presidenti pritet të mbledhë Këshillin Sigurisë Kombëtare

Burime nga Presidenca bëjnë me dije se Presidenti i Republikës do të mbledhë Këshillin e Sigurisë Kombëtare, në lid...

AKTUALITET 24 Shtator17:39

Zbulohet portreti i Shpëtim Aliut, "kumbari" që furnizonte grupet kriminale me drogë u arrestua në Rusi

Zbulohet portreti i Shpëtim Aliut i cili u arrestua mbrëmjen e së mërkurës në Rusi me qëllim ekstradimin drejt Shqipëris...

AKTUALITET 24 Shtator17:30

SafeJournalists: Deklarata e Hysenit ndaj Klodiana Lalës ngre shqetësime për mbikëqyrjen e gazetarëve

Rrjeti SafeJournalists ka reaguar pas sulmit të ish-drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni ndaj gazetares Klodiana Lala. Në një reagim zyr...

AKTUALITET 24 Shtator17:02

SKANDAL/ Po filmonte protestën, efektiv i rrëmben nga dora telefonin qytetares

Një situatë e tensionuar është shënuar ditën e sotme gjatë protestës së qytetarëve para Kuvendit. Në nj&...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

U vra nga pronari italian i banesës, del autops...

Pak ditë pas vrasjes së 36-vjeçarit shqiptar Gjovalin Lazri nga pronari italian i një banese, mediat italiane japin të tjera detaje p...

AKTUALITET 24 Shtator

Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në nj&eum...

AKTUALITET 23 Shtator

"Ergys Agasi filmonte video gjatë takimeve në z...

Gazetarja Anduena Llabani, ndau detaje të tjera në lidhje me hetimet e SPAK-ut në dosjen ku është përfshirë edhe drejtoresha ...

Nga Xhulian Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1






PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



"Dua 120 mijë euro"/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit



Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.